



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

---

Numri i lëndës: 2019:198450

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05734695

KE.nr.140/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të paditësve 1.DARDAFON.NET LLC, me numër të biznesit 70540878 me seli në adresën rr.”Dëshmori”, nr.23, fshati Miradi e Epërme, Fushë Kosovë, 2.B.D. me numër personal ..., me adresë rr.”Hasan Prishtina” nr.28, me seli në Pejë, të cilët i përfaqëson Kushtrim Palushi dhe Visar Ramaj nga Avokatura “RAMAJ & PALUSHI” me seli të zyrës në adresën Qamil Hoxha nr.13/5, në Prishtinë, kundër të paditurit N.SH INFOKUSI, me numër të biznesit 71144852, me seli në adresën rr. “Beqir Kastrati”, Ob.2, nr.29, Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e dëmit nga shpifja dhe fyerja, jashtë seancës me datën 24.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komeriale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet JO KOMPETENTE në pikëpamje lëndore, për të vendosur sipas padisë së paditësve 1. DARDAFON.NET LLC, dhe 2. B.D. me numër të lëndës KE.nr.140/22 (2019:198450) të datës 16.08.2017, kundër të paditurit N.SH INFOKUSI, me objekt kontesti kompensim dëmi nga shpifja dhe fyerja.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Paditësit DARDAFON.NET LLC dhe B.D., me datë 16.08.2017 kanë paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, kundër të paditurit N.SH INFOKUSI, me të cilën kanë kërkuar që të aprovet si e bazuar kërkesëpapia e paditësve dhe të obligohet i padituri që paditësve ti kompensoj dëmin, në emër të dëmit jo material për shkak shpifjes dhe fyerjes.

Kjo lëndë, është transferuar në Gjykatën Komerciale sipas Vendimit nr.347/2022 të datës 28.07.2022 të KGJK-së për transferimin e lëndëve në Gjykatën Komerciale.

Gjykata gjatë shqyrtimit të padisë dhe shkresave të lëndës në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së, vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës në këtë çështje juridike dhe gjeti se Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Gjykata duke u bazuar në nenin 13 par. 1.1 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, me të cilin përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*, lidhur me paragrafin 2 i cili përcakton se: *“Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Ekonomike”*, vlerëson se çështjet që kanë të bëjnë me shpifje dhe fyerje, nuk bien në kompetencë të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Departamenti për Çështje Ekonomike, për shkak se shpifja dhe fyerja, nuk hyn në kuadër të çështjeve të ndërsjella tregtare dhe as çështjeve tjera që ndërlidhen me raportet afariste në mes tyre, ndërsa duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr. 06/L-054), kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 lidhur me nenin 387.1 pika (u) dhe nenin 392 pika. (b) të LPK-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.140/22, datë 24.05.2024

Gjyqtari  
Arnis Dumani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.